

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XXII, nr. 6692  
E martë, 30 gusht 2022  
çmimi 0.40

Murati: Punëtorët që janë në grevë nuk do ta marrin pagën e plotë

FAQE 5



Na ndiqni edhe në:

[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)

facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

## OPOZITA DHE SHOQËRIA CIVILE KËRKOJNË NGA KURTI TA PUBLIKOJË MARRËVESHJEN E ARRITUR NË BRUKSEL




Opozita dhe shoqëria civile kanë kërkuar nga qeveria Kurti ta publikojë marrëveshjen e arritur në Bruksel me Serbinë për dokumentet. Ish-kryenegociatorja e dialogut Kosovë - Serbi, Edita Tahiri, ka pyetur qeverinë Kurti se pse nuk po publikohet teksti i marrëveshjes. Edhe Petrit Zogaj

ka thënë se ka dy ditë që po flitet për një marrëveshje të arritur në mes të Kosovës dhe Serbisë por, sipas tij, askush nuk e parë këtë marrëveshje. Po ashtu, edhe deputeti i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Hisen Berisha, ka kërkuar që të publikohet marrëveshja e arritur

## ABETARJA E PARË E UNIFIKUAR KOSOVË - SHQIPËRI MË 1 SHTATOR NË DUART E VOGËLUSHËVE

FAQE 7



POLICIA NIS PATRULLIMET ME VETURA INTELIGJENTE

FAQE 7

## AKTUALE



KANCELARI GJERMAN DO QË BALLKANI PERËNDIMOR TË PËRFSHIHET NË ZGJERIMIN E BE-së

F. 3

KMDLNJ: ÇFARË GARANCISH KËRKOI BORRELLI NGA KRYEMINISTRI KURTI PËR SERBËT E VERIUT?! F. 6

NDËRTIMI I SPITALIT TË PRISHTINË DO TË NISË VITIN E ARDHSHEM F. 7

## EKONOMI



BANKA BOTËRORE: KOSOVA PO DËSHMON MENAXHIM TË MIRË NDAJ KRIZAVE VITET E FUNDIT F. 8

LDK-ja: QEVERI, PRANOJE PLANIN DHJETËPIKËSH DHE SHPËTOJI QYTETARËT NGA KATASTROFA ENERGETIKE F. 8

## SPORT



KASTRATI PREZANTOHET TE FERENCVAROSHI: DUA FTESË NGA TRAJNERI I KOSOVËS F. 10

**RENOVA**  
PUTZ  
Maqedoni  
Xhepçisht - Tetovë  
Gurëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
Mob: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**Kolegji BIZNESI**  
[www.kolegji.biznesi.com](http://www.kolegji.biznesi.com)  
info@kolegji.biznesi.com  
030 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**INFINITY**  
Digital Agency  
Endrit Shaqiri  
+38344685122  
Internet Website,  
Marketing...

## Ekspertët e OKB-së vizitojnë këtë javë Zaporozhjan

**NJU JORK, 29 GUSHT** - Një mision i agjencisë së Organizatës së Kombeve të Bashkuara (OKB) për siguri bërthamore pritet që gjatë kësaj jave ta vizitojë centralin ukrainas të Zaporozhjas të okupuar nga rusët. Luftimet në këtë central kanë rritur frikën për një rrjedhje të mundshme masive të rrezatimit.

Rafael Grossi, kreu i Agjencisë Ndërkombëtare për Energji Bërthamore, ka thënë në "Twitter" se "ka ardhur dita", dhe se një ekip ekspertësh i kësaj agjencie "tani është nisur" për në centralin bërthamor, të cilin forcat ruse e pushtuan pak pasi Moska nisi pushtimin e Ukrainës më 24 shkurt.

"Ne duhet të mbrojmë sigurinë e centralit të Ukrainës dhe njëherësh centralit më të madh bërthamor të Evropës. Jam krenar që udhëheq këtë mision që do të jetë në Zaporozhja më vonë gjatë kësaj jave", ka shkruar Grossi.

Ekspertët e Kombeve të Bashkuara pritet ta bëjnë vlerësimin e dëmeve në central, ta përcaktojnë funksionalitetin e

sistemeve të sigurisë, t'i vlerësojnë kushtet e stafit dhe të kryejnë aktivitete urgjente të sigurisë, ka njoftuar agjencia.

Shqetësimet e sigurisë në këtë central janë përshkallëzuar javët e fundit, teksa Kiev dhe Moska kanë këmbëyer akuzat lidhur me sulmet me raketa përreth centralit që gjendet në qytetin jugor ukrainas të Enerhodarit.

Sulme janë raportuar gjatë fundjavës jo vetëm në territorin e kontrolluar nga rusët ngjitur me centralin përgjatë anës së majtë të bregut të Lumit Dniepër, por edhe përgjatë anës së djathtë që kontrollohet nga Ukraina. Sulme janë raportuar edhe në qytetet Nikopol dhe Marhanets, që gjenden rreth 10 kilometra nga centrali i Zaporozhjas.

Agjencia bërthamore ukrainase, Enerhoatom, ka publikuar një hartë më 28 gusht. Kjo hartë parashikonte se ku mund të përhapej rrezatimi nga centrali në rast të ndonjë aksidenti, duke thënë se në bazë të parashikimeve të erërave për 29 gusht, retë bërthamore mund të përhapeshin në mbarë Ukrainën



jugore dhe Rusinë jugperëndimore.

Javën e kaluar, autoritetet nisën të shpërndanin ilaçe jodi për banorët që jetojnë afër centralit të Zaporozhjas, që do të duhej t'i përdornin në rast të ekspozimit ndaj rrezatimit.

Shumica e shqetësimeve kanë të bëjnë me sistemet e ftohjes së reaktorëve të centralit. Këto

sisteme operojnë përmes rrymës dhe centrali përkohësisht u shkëput nga rrjeti elektrik më 25 gusht, për shkak të, siç thanë zyrtarët, një zjarr kishte dëmtuar një linjë të transmisionit. Një dështim i sistemeve të ftohjes do të mund të shkaktoje një shkrirje bërthamore.

Enerhoatom ka thënë më 27 gusht se granatimet periodike

kanë shkatërruar infrastrukturën e centralit.

Agjencia Ndërkombëtare për Energji Bërthamore ka thënë më 28 gusht se nivelet e rrezatimit ishin normale dhe se dy prej gjashtë reaktorëve të Zaporozhjas ishin duke funksionuar. Po ashtu është raportuar se nga luftimet ishte dëmtuar një tubacion uji, që veçse është riparuar.

## Suedia jep ndihmë të re ushtarake për Ukrainën

**STOKHOLM, 29 GUSHT** - Kryeministrja suedeze, Magdalena Andersson, ka bërë me dije se Suedia do të ofrojë një pako të re të ndihmës ushtarake për Ukrainën, me qëllim që shteti ta mbrojë veten nga pushtimi i Rusisë. Paketa e re e ndihmës do të jetë në vlerë prej 500 milionë kronash apo 46.75 milionë dollarësh.

Anderssoni, pasi është takuar me ministrin e Jashtëm ukrainas, Dmytro Kuleba, ka thënë për gazetaret se qeveria e saj do të ofrojë edhe një paketë të ndihmës prej 1 miliard kronash. Kjo do të

jetë ndihmë ushtarake dhe civile për Ukrainën.

Ndërsa ministri Kuleba ka thënë se Suedia do t'i ofrojë shtetit të tij armë sikurse obusë dhe granata. "Për aq kohë sa lufta vazhdon, ne do të kërkojmë më shumë armë. Çdo euro, çdo plumb, çdo granatë është e rëndësishme", ka thënë Kuleba.

Më tutje, kryeministrja suedeze nuk ka dhënë detaje për paketën ushtarake, por ka thënë se do të jetë e ngjashme me ndihmën e mëparshme, që ka përfshirë armë kundërtanke, pajisje për mbrojtjen e ushtarëve dhe pajisje



për pastrimin e minave.

"Ne do të vazhdojmë të mbështesim Ukrainën për aq kohë sa lufta vazhdon", ka thënë Anderssoni.

Në pjesën e ndihmës civile përfshihet edhe blerja e grurit ukrainas, që më pas do t'iu dërgohet shteteve që po përballen me mungesë të ushqimeve. Kjo, sipas Suedisë, bëhet për të mbështetur ekonominë ukrainase.

Qëkur Rusia nisi pushtimin e Ukrainës më 24 shkurt, shtetet perëndimore kanë ofruar ndihmë ushtarake dhe civile për Kiev.

## Gjermania lidhet me qendrën në Baltik për energji të ripërtërishme

Berlin, 29 gusht - Gjermania ka siguruar një lidhje energjetike me qendrën që planifikohet të ndërtohet në Detin Baltik për prodhimin e energjisë përmes erës. Kjo pritet t'i ndihmojë Berlinit që të ulë varësinë që ka ndaj energjisë ruse, bëri të ditur Ministria e Energjisë së Danimarkës, vendit ku do të ndërtohet kjo qendër.

Qendra e planifikuar e energjisë në ishullin Bornholm pritet të ndërtohet më 2030. Kjo qendër do të ketë lidhje me disa parqe të erës në Baltik dhe do të ketë kapacitet të prodhimit të paktën prej 3 gigavatësh, që janë të mjaftueshme për të ofruar energji për 4.5 milionë amvisëri gjermane, ka njoftuar Ministria e Energjisë.

Qendra erës do të lidhet me Gjermaninë përmes një kabllaje të energjisë të gjatë prej 470 kilometrash.

Investimet dhe përfitimet në të ardhmen do të ndahen në mënyrë të barabartë midis Gjermanisë dhe Danimarkës, është thënë në njoftimin e ministrisë gjermane, pa dhënë detaje për koston financiare.

"Bashkëpunimi danezo-gjerman është projekti kryesor. Rryma e gjelbër nga ishulli Bornholm do të furnizojë prodhimin kombëtar të energjisë dhe do të ulë varësinë tonë nga importet e energjisë fosile", ka thënë ministri gjerman i Ekonomisë dhe Klimës, Robert Habeck, përmes një njoftimi.

Vitin e kaluar, të dy shtetet kanë

funksionalizuar një kablo të energjisë, që po ashtu lidhet edhe me disa ferma të tjera të erës në Detin Baltik.

Projekti në Bornholm është pjesë e një plani më të gjerë të Danimarkës që ka për synim që në vitin 2030 të pesëfishojë prodhimin e energjisë përmes erës, në qendrat në det të hapur.

Planet e mëhershme të shteteve veriore të Evropës për të krijuar një linjë të përbashkët energjetike nën Detin e Veriut, me qëllim që të lidhej me fermat e erës, kanë hasur në probleme financiare dhe sfida ligjore.

Danimarka do të jetë nikoqire e samitit të energjisë në Detin Baltik, i cili do të mbahet të martën.



## Kërkohet të ndahen nga 100 euro edhe për punonjësit e sektorit privat

PRISHTINË, 29 GUSHT - Krahas kërkesave dhe grevave që po mbahen në vend nga punëtorët e sektorit publik për mbështetje financiare në paga shtesë, po kërkohet po ashtu mbështetje financiare prej qeverisë edhe për punëtorët e sektorit privat me nga 100 euro.

Si rrjedhojë e krizës energjetike dhe inflacionit të lartë, sektori privat po ballafaqohet me

probleme financiare, ruajtjen e vendeve të punës dhe prodhimin.

Eksperti i ekonomisë, Safet Gërxhaliu, ka thënë për "Kosovapress" se situata ekonomike dhe sociale në Kosovë është rënduar si pasojë e inflacionit dhe krizës energjetike. Ai ka thënë se Qeveria e Kosovës duhet t'i trajtojë të gjithë sektorët e punës

njësoj dhe nuk duhet anashkaluar sektorin privat i cili është mbushës i buxhetit të shtetit.

Gërxhaliu ka thënë se edhe punëtorët e sektorit privat duhet të mbështeten me nga 100 euro. Ai ka theksuar se është obligim institucional ta mbështesë qytetarin dhe punëtorët në këtë kohë kur ka ngritje të çmimeve të pakontrolluar.



## Kancelari gjerman do që Ballkani Perëndimor të përfshihet në zgjerimin e BE-së

PRAGË, 29 GUSHT - Kancelari gjerman Olaf Scholz ka thënë se ai është "i përkushtuar" për zgjerimin e Bashkimit Evropian (BE) për të përfshirë në të gjashtë shtetet e Ballkanit Perëndimor, por edhe Ukrainën e Moldavinë, si dhe Gjeorgjinë.

Ai ka thënë se "qendra e Evropës po lëvizjes drejt lindjes". "Anëtarësimi i tyre në BE është në interesin tonë", ka thënë Scholz gjatë një fjalimi më 29 gusht në Universitetin Çarls të Pragës, teksa ka shpaluar vizionin e tij për një Evropë të zgjeruar. Kosova, Shqipëria, Maqedonia e Veriut, Mali i Zi, Bosnjë e Hercegovina dhe Serbia, që të gjitha po kërkojnë anëtarësim në BE. Por, gjashtë shtetet e Ballkanit kanë shprehur zhgënjimin e tyre për shkak të ngecjeve në proces, veçanërisht pasi blloku vendosi në qershor, përmes një procesi të përshpejtuar, që t'i japë Ukrainës dhe Moldavisë statusin e vendit kandidat.

Nga shtetet e Ballkanit Perëndimor, Serbia dhe Mali i Zi janë në një stad më të përparuar drejt anëtarësimit, dhe dy shtetet kanë hapur disa kapituj me BE-në. Shqipëria dhe Maqedonia e Veriut korrikun e këtij viti kanë nisur bisedimet për anëtarësim, ndërkaq Kosova dhe Bosnjë e Hercegovina mbeten të fundit në rajon sa i përket rrugëtimit të tyre drejt BE-së. Prishtina dhe Sarajeva ende nuk kanë fituar statusin e vendit kandidat. Në dritë të pushtimit rus të



Ukrainës, Scholz u ka bërë thirrje të 27 anëtarëve të bllokut që të "zgjidhin konfliktet e vjetra dhe të gjejnë zgjidhje të reja", duke shtuar se Gjermania do të vazhdojë mbështetjen e saj për Kievin "për aq kohë sa të jetë e nevojshme". "Në këtë bllok të zgjeruar, dallimet midis shteteve anëtare do të rriten sa i përket interesave politike, ndikimit ekonomik dhe sistemeve të

sigurisë shoqërore. Ku kërkohet unanimiteti në ditët e sotme, rreziku që shtetet individuale të përdorin veton dhe të parandalojnë shtetet e tjera për të marrë vendime, rritet pas çdo anëtarësimi të ri. Prandaj, kam propozuar një tranzicion gradual drejt votimit përmes shumicës për politikën e përbashkët të jashtme, por edhe për çështje të tjera, sikurse politikën tatimore, duke e

ditur shumë mirë se kjo mund të ketë pasoja për Gjermaninë", ka thënë Scholz. Shtetet e BE-së, sikurse Kroacia, Rumania dhe Bullgaria plotësojnë të gjitha kriteret që të bëhen anëtare me të drejta të plota në zonën për lëvizjen e lirë, Shengen, ka thënë Scholz. "Shengeni është një prej arritjeve më të mëdha të BE-së, dhe ne duhet ta mbrojmë dhe ta zhvillojmë atë. Kjo

nënkupton se duhet të mbyllen boshllëqet që kanë mbetur", ka thënë kancelari gjerman.

Scholzi ka akuzuar presidentin rus, Vladimir Putin, se po kërkon që të "ndryshojë kufijtë përmes dhunës" dhe se pushtimi rus i Ukrainës është "një sulm ndaj rregullit të sigurisë së Evropës". "Ne nuk do të rrimë duarkryq dhe të shikojmë se si gratë, burrat dhe fëmijët po vriten ose të shohim shtetet e lira të fshihen nga harta dhe të zhduken pas mureve apo perdeve të hekurta. Ne nuk duam të kthehemi në shekullin e 19-të apo të 20-të me luftërat pushtuese dhe me totalitarizëm. Është pikërisht kjo Evropë e bashkuar është kaq anatemë për Putinin. Sepse nuk përkon me vizionin e tij për botën, në të cilin shtetet e vogla detyrohen t'iu nënshtrohen një grushti fuqish të mëdha evropiane", ka thënë ai, duke Gjermania do të dërgojë armë për Kievin në javët në vijim. "Në javët dhe muajt në vijim, ne do të dërgojmë armë të reja për Ukrainën, sikurse sisteme të mbrojtjes ajrore, sisteme radarësh dhe dronë. Paketa jonë e fundit e ndihmës me armë kishte vlerën prej 600 milionë eurosh. Qëllimi ynë është që ushtria moderne ukrainase të jetë në gjendje të mbrojë shtetin e tyre", ka thënë Scholz. Ai ka thënë se Gjermania mund të marrë përsipër edhe detyra të reja, në kuptimin e ndërtimit të kapaciteteve të artilerisë dhe mbrojtjes ukrainase.

## Mehaj: ShBA-ja mbështet tranzicionin e Ministrisë së Mbrojtjes dhe FSK-së

PRISHTINË, 29 GUSHT - Ministri i Mbrojtjes, Armend Mehaj, ka pritur në takim ekipin e Institutit për Qeverisje të Sigurisë (ISG) nga ShBA-ja, i kryesuar nga Keith Dunn, të cilët do ta vazhdojnë ciklin e radhës të këshillëdhënies njëjavore në Ministrinë e Mbrojtjes. Me këtë rast, Mehaj ka shprehur mirënjohje për punën në mbështetjen e Ministrisë së

Mbrojtjes për hartimin e politikave, planifikim dhe instrumentet e tjera të nevojshme për realizimin efektiv të procesit të tranzicionit dhe zhvillimit të Ministrisë së Mbrojtjes dhe FSK-së. "Me ekspertët amerikanë do të vazhdojmë suksesshëm edhe më intensivisht drejt realizimit të vizionit tonë", ka shkruar Mehaj në "Facebook".





# Opozita dhe shoqëria civile kërkojnë nga Kurti ta publikojë marrëveshjen e arritur në Bruksel

Opozita dhe shoqëria civile kanë kërkuar nga qeveria Kurti ta publikojë marrëveshjen e arritur në Bruksel me Serbinë për dokumentet. Ish-kryenegociatorja e dialogut Kosovë - Serbi, Edita Tahiri, e ka pyetur qeverinë Kurti se pse nuk po publikohet teksti i marrëveshjes. Edhe Petrit Zogaj ka thënë se ka dy ditë që po flitet për një marrëveshje të arritur në mes të Kosovës dhe Serbisë por, sipas tij, askush nuk e pa këtë marrëveshje. Edhe deputeti i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Hisen Berisha, ka kërkuar që të publikohet marrëveshja e arritur

**EPOKA  
ERE**

Mal QORRAJ

**PRISHINË, 29 GUSHT** - Kosova dhe Serbia janë pajtuar të heqin dorë nga lëshimi i dokumentit për hyrje-dalje për shtetasit e të dy vendeve, mirëpo ende Qeveria e Kosovës nuk e ka publikuar këtë marrëveshje.

Për këtë ujdi me palën serbe, kryeministri Albin Kurti ka dhënë një deklaratë të shkurtër në llogarinë e vet në "Facebook". "Qytetarët e Republikës së Kosovës, me dokumente identifikimi (ID) të lëshuara nga shteti ynë, do të mund të kalojnë pa pengesa, ngarkesa e vonesa kufirin me Serbinë në të gjitha vendkalimet kufitare. Njësoj do të vlejë edhe për kahjen e kundërt me rastin e hyrjes në Kosovë me

dokumente identifikimi (ID) të lëshuara nga autoritetet e Serbisë", ka shkruar Kurti, duke theksuar se fryma e bisedimeve parimore e të barabarta në Bruksel është reciprociteti.

"Zgjidhjet normalizuese duhet ta kenë reciprocitetin përbrenda, teksa marrëdhëniet e mira fqinjësore e nënkuptojnë atë", ka shkruar Kurti.

Ndërkaq zërat në Kosovë nga opozita dhe shoqëria civile janë rritur për mospublikimin e kësaj marrëveshje nga ana e qeverisë. Ish-kryenegociatorja e dialogut Kosovë - Serbi, Edita Tahiri, ka pyetur qeverinë Kurti se pse nuk po publikohet teksti i marrëveshjes. "Marrëveshja për finalizimin e zbatimit të marrëveshjes për lëvizjen e lirë 2011 u arrit për letra shoqëruese,

ajo e targave po pritet. Pyetja është pse nuk po publikohet teksti i kësaj marrëveshjes?", ka shkruar Tahiri në llogarinë e vet në "Facebook".

Edhe Petrit Zogaj, njohës i proceseve politike, ka pritur që qeveria Kurti do ta publikonte marrëveshjen e arritur. Ai ka thënë se ka dy ditë që po flitet për një marrëveshje të arritur në mes të Kosovës dhe Serbisë por, sipas tij, askush nuk e pa këtë marrëveshje. "Presidentja e kryeministri pak a shumë uruan për këtë marrëveshje. Thanë që ky është reciprociteti. Ana tjetër e politikës thanë që kjo marrëveshje nuk është asgjë tjetër pos ajo e vitit 2011. Mirëpo, askush nuk e pa këtë marrëveshje. Askush nuk e botoi. Qeveria jo se jo. Nuk doli asnjë draft i saj. Nuk u kuptua a është marrëveshja e vjetër apo diçka e re. U tha që u arrit marrëveshja, nuk thanë që u nënshkrua.

Nuk thanë as që a do të nënshkruhet, as nga kush apo kur. Nëse është nënshkruar, nuk u tha nga kush dhe kur ndodhi një gjë e tillë. Me një fjalë, asgjë nuk u botua e nuk u konfirmua. Por ama, nga ana e pushtetit, kjo marrëveshje u festua", ka shkruar Zogaj në "Facebook".

Sipas tij, partitë opozitare duket se janë të zëna me të tjera probleme, disa me pjesëmarrje

në dasma e syneti, të tjerat me klube nate.

Deputeti i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Hisen Berisha, ka kërkuar që të publikohet marrëveshja për dokumentet e arritur në mes të kryeministrit Albin Kurti me presidentin serb Aleksandër Vuçiq. Ai ka thënë se derisa në opinion nuk ka një dokumente të nënshkruar, marrëveshjen Kurti-Vuçiq do ta quajë të ngjashme me atë të Ahmet Zogut dhe Nikolla Pashiqit. "Përderisa nuk ka në opinion një dokument të shkruar dhe të nënshkruar midis palëve në bisedimet Kosovë - Serbi me ndërmjetësimin e BE-së dhe të lehtësuar nga Escobari, e vlerësojë këtë 'marrëveshje' të ngjashme me marrëveshjen e Ahmet Zogut me Nikolla Pashiqin! Pala ndërmjetësuese duhet ta publikojë tekstin e marrëveshjes ose duhet ta ndërpresë mashtrimin e opinionit. Është joseriozitet, flasin për marrëveshje, pa tekstin e dokumentit! Ku po vemi?", ka shkruar Berisha në "Facebook".

E ish-ministrja Melihate Tërmkollit, e cila për disa mandate ka qenë deputete e Kuvendit të Kosovës, është ndalur fillimisht te ftesa e Kurtit për takim me liderët e opozitës dhe pastaj ka reaguuar edhe për mospublikimin e

marrëveshjes së arritur me Serbinë për dokumentet. "Me opozitën duhet takime e takime para marrëveshjeve, madje edhe grup i përbashkët negociues për marrëveshjen finale dhe jo takime 'informative', 'post festum'. Eventualisht, ndoshta kryeministri Kurti ua tregon ndonjë letër të 'marrëveshjes për dokumentet' të cilën askush nuk po e sheh!. Përndryshe informatat për bisedime i ka bërë publike Vuçiqi të nesërmen e takimit në Bruksel", ka shkruar Tërmkollit në "Facebook".

Kjo marrëveshje e lëvizjes së lirë për qytetarët e dyja vendeve është arritur në vitin 2011 në kuadër të dialogut në Bruksel.

Anëtar i kryesisë së PDK-së, Betim Gjoshi, ka thënë se sot Albin Kurti dhe Vetëvendosje po gëzohen shumë që po arrijnë t'i zbatojnë marrëveshjet e Hashim Thaçit. "Ky nuk është sukses, por mjerim për Kosovën dhe vitet e humbura për shkak të një njeriu - Albin Kurtit. Për një dekadë i ka mashtruar e gënjyer qytetarët e Kosovës duke iu thënë se në Bruksel po nënshkruhen akte tradhtie kundër Republikës së Kosovës. Kurse sot krenohet duke thënë se asnjë pikë dhe asnjë presje nuk ua heq marrëveshjeve të Hashim Thaçit", ka deklaruar Gjoshi.

## Murati: Punëtorët që janë në grevë nuk do ta marrin pagën e plotë

PRISHTINË, 29 GUSHT - Punëtorët e sektorit publik që janë në grevë nuk do ta marrin pagën e plotë nga Qeveria e Kosovës, ka thënë ministri i Financave, Punës dhe Transfereve, Hekuran Murati. "Për pesë ditë pune i bie rreth 90 euro minus këtë muaj [në pagë]", ka thënë Murati më 29 gusht, në një konferencë për medie.

Nga e enjta e 25 gushtit në grevë janë mësimitdhënësit, edukatorët në kopshtet publike, shërbyesit civilë në institucionet lokale dhe qendrore të Kosovës.

Kërkesa kryesore e sindikatave të këtyre punëtorëve, drejtuar Qeverisë së Kosovës, është ndarja e nga 100 eurove për punëtorët derisa të hyjë në fuqi Projektligji për pagat.

Murati ka thënë se praktikat dhe konventat ndërkombëtare nuk e obligojnë punëdhënësin t'i paguajë grevistët për atë kohë sa ata janë në grevë. "Kur punëtorët hyjnë në grevë, grevistët mbulohen [kompensohen] nga sindikata. Në pesë vitet e fundit, nga Thesari i Kosovës, rreth 3.2 milionë euro është shuma e

mjeteve që u janë ndalë nga paga punëtorëve të arsimit [në emër të anëtarësisë] me urdhër të Sindikatës së Bashkuar për Arsim, Shkencë dhe Kulturë (SBASHK) dhe janë bartur në llogari të kësaj sindikate", ka thënë Murati.

Greva është organizuar nga Bashkimi i Sindikatave të Pavarura të Kosovës, duke theksuar se nëse qeveria nuk reflekton, greva nuk do të ndërpritet dhe nxënësit nuk do ta fillojnë vitin e ri shkollor, që duhet të nisë më 1 shtator.

BSPK-ja përmes një komunikate për medie më 26 gusht i ka quajtur kërcënime deklaratat e sekretarit të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve, Enis Spahiu, se nëse edhe për një orë një zyrtar është në grevë, ai nuk do të paguhet për atë orë.

Në Ligjin për Greva të Kosovës thuhet se "organizatat sindikale, apo gjysma e të punësuarve të një organizate të caktuar punuese, ku nuk ka organizim sindikal, kanë të drejtë të organizojnë greva, për



t'i mbrojtur interesat e tyre ekonomike, sociale dhe profesionale'.

Neni 18 i Ligjit për Greva thotë se gjatë zhvillimit të grevës

pezullohen detyrimet që rrjedhin nga kontrata e punës, duke përfshirë të drejtën në pagesë dhe detyrimin e bindjes për të punuar

Por, sipas Ligjit për Greva, ndërprerja ose largimi nga marrëdhënia e punës për shkak të pjesëmarrjes në një grevë të ligjshme është i kundërligjshëm.

## Disa nga themeluesit e UÇK-së vizitojnë babanë e ish-presidentit Thaçi



Skenderaj, 29 gusht - Nënkryetari i komunës së Skenderajt, Sami Lushtaku, ka bërë me dije se me një pjesë të themeluesve

të UÇK-së, Jakup Nura, Fadil Kodra, Sahit Jashari e Zenun Kodra, kanë shkuar për vizitë te baca Haxhi, babai i ish-presidentit

Hashim Thaçi. "Ai qëndron i fortë e krenar si gjithmonë për të birin, i cili ka dhënë kontribut të jashtëzakonshëm për

themelimin jo vetëm të UÇK-së, por edhe të shtetit të Kosovës!", ka shkruar Lushtaku në llogarinë e vet në "Facebook".

# Çfarë garancish kërkoi Borrelli nga kryeministri Kurti për serbët e veriut?!

Reagim i Këshillit për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut (KMDLNj)

Pas bisedimeve të ndërmjetësuar nga BE-ja e të përkrahura nga SHBA, u arrit pajtueshmëria e zbatimit të Marrëveshjes për Liri të Lëvizjes e nënshkruar në vitin 2011 përmes njohjes së dokumenteve. Pas kësaj plasi polemika për meritat e kësaj marrëveshjeje ndonëse gjërat ishin dhe janë të qarta se çka ishte nënshkruar dhe pjesërisht për çka është arritur pajtueshmëria pas një presioni të madh ndërkombëtar. Për KMDLNj ende nuk është e qartë se çka përmban pajtueshmëria sepse mungon një tekst integral, nëse ka apo një sqarim i plotë i kryeministrit Kurti për qytetarët e Kosovës. Për KMDLNj është tregues shqetësues deklarimi i Borrellit pas arritjes së pajtueshmërisë se ka marrë garanci nga kryeministri Kurti për serbët e veriut. Për çfarë garancish bëhet fjalë e për të cilët nuk janë informuar qytetarët e Kosovës? Pastaj, nëse bëhet fjalë për reciprocitet të plotë, pse Serbia do ua lëshojë qytetarëve të

Kosovës një letër ku shkruan se pajtueshmëria për njohje reciproke të dokumenteve nuk nënkupton se Serbia e njeh Kosovën. Nëse kështu veprohet, qytetarët e Kosovës nuk duhet ta pranojnë atë letër edhe me kusht se do të kthehen mbrapsht.

Opozita e Kosovës duhet të jetë konstruktive vetëm në rast se kryeministri Kurti siguron transparencë të plotë për arritjen e pajtueshmërisë me palën serbe e që, deri më tani kemi vetëm informata të fragmentarizuara nga mediet. Asgjë më shumë. KMDLNj pret intensifikim të presionit për formim të Asociacionit prandaj edhe po kërkohet bashkëpunim me opozitën, për ndarje të përgjegjësive. Nënshkrimi i një Marrëveshjeje përfundimtare me Serbinë nuk mund të jetë përgjegjësi e vetëm një subjekti politik apo një lideri, pavarësisht fuqisë së votave që i ka.

KMDLNj është i sigurt se Asociacioni nuk e dërgon vendin në zgjedhje të parakohshme aq më parë që



as ndërkombëtarët nuk janë te interesuar për këtë. Garantimi i pakushtëzuar i lirisë së lëvizjes për të gjithë qytetarët, pa bërë asnjë dallim, për KMDLNj është përparim i realizimit të drejtave të njeriut dhe, si e tillë edhe përkrahet. Mirëpo, në anën tjetër mungesa e transparencës për këtë pajtueshmëri, sidomos e

palës kosovare lë hapësirë për dyshime të caktuara. KMDLNj nuk mbështetet në deklaratat e Vuçiqit sepse ai i sajton sipas dhe për qëllime politike ndërsa Borrell, mund të konsiderohet lirisht si i anshëm dhe jokorrek në tërë këtë proces. Kryeministri Kurti e ka për detyrim ligjor dhe moral t'i drejtohet qytetarëve

të Kosovës, pa bërë dallime politike, partiake, në baza kombëtare, fetare etj., dhe t'i informojë drejtë për këtë pajtueshmëri, deri diku të mjegulluar. Euforia e fitores së çastit duhet t'i lë vend zgjedhjeve shumë më të rënda me të cilat do të përballet Kosova në një të afërme të afërt.

## Analiza e Fondacionit "Rockefeller Brothers": "Ballkani i hapur" minoi "Nismën e Berlinit" dhe thelloi përçarjet në rajon

PRISHTINË, 29 GUSHT - Një analizë e Fondacionit "Rockefeller Brothers" për nismën e Berlinit në Ballkanin Perëndimor tregoi se "Ballkani i hapur", një iniciativë e Shqipërisë, Serbisë dhe Maqedonisë, minoi qëllimin për Tregun e Përbashkët Rajonal që u prezantua nga nisma e Berlinit.

Autorët e studimit evidentuan se arsyeja e nismës së "Ballkanit të Hapur" ka qëllim të lejojë disa vende të rajonit të përparojnë më shpejt në bashkëpunimin ekonomik duke anashkaluar mosmarrëveshjet dypalëshe që bllokojnë nismën në nivel Rajonal.

Mirëpo, sipas tyre, "Open Ballkan" anashkalon bashkëpunimin rajonal, duke përjashtuar Kosovën dhe rrjedhimisht duke anashkaluar grackat e marrëdhënies Kosovë-Serbi. "Përfshirja e gjysmës së BB6 në nismën e Ballkanit të Hapur mund të ketë implikime negative në aspektin simbolik dhe në bashkëpunimin real", thuhet në analizën që studimi zhvilloi mbi zbatimin e "Nismës së Berlinit 200-2021". Për më tepër "Open

Ballkan", rrezikon të zëvendësojë qëllimin dhe konceptin e krijimit të Tregut të Përbashkët Rajonal që është në themel të nismës së Berlinit.

"Edhe pse nisma e Ballkanit të Hapur nuk ka lindur domosdoshmërisht nga zhgënjimi lidhur me çështjet e zgjerimit, udhëheqësit e përfshirë duket se e mirëpresin idenë që nuk duhet të adresojnë standardet evropiane brenda saj" thuhet në studim.

Tre vendet e tjera të BB6, Bosnja, Kosova dhe Mali i Zi mbeten të shqetësuar nga ideja për t'iu bashkuar nismës. Kosova në mënyrë hapur e ka kundërshtuar nismën e Ballkanit të Hapur dhe qëllimet e saj. Në mënyrë të ngjashme, udhëheqja e Bosnjë-Hercegovinës ka shprehur shqetësimin se zona ekonomike rajonale rrezikon pavarësinë e saj. Së bashku me Malin e Zi, të dyja vendet zyrtarisht pretenduan se nuk shohin arsye për të preferuar iniciativën e "Open Ballkan" mbi tregun e përbashkët që udhëhiqet nga nisma e Berlinit.

BE-së i mungon ende një qëndrim përfundimtar për



nismën e Ballkanit të Hapur. Zyrtarët Evropiane që kanë vizituar Ballkanin së fundmi kanë mirëpritur rritjen e bashkëpunimit Rajonal. Për të ndihmuar në liberalizimin e tregtisë, "Ballkani i hapur" synon të heqë kalimet kufitare dhe barrierat për tranzit, mirëpo duke qenë se është gjysmake i ka përmbysur të gjithë

arritjet e nismës së Berlinit, që synonte rritjen e bashkëpunimit në Rajon si një i tërë, analizon me tej studimi. "Ballkani i Hapur", nisma e nisur në fund të korrikut 2021 nga Serbia, Maqedonia e Veriut dhe Shqipëria përfshin vetëm gjysmën e vendeve të Ballkanit Perëndimor, ndërsa nisma e

Berlinit ishte e pranuar nga të gjitha vendet për të arritur standardet që krijonin tregun e përbashkët.

Autorët pohojnë se "Open Ballkan" mund të rriste më tej ndasitë në Rajon sidomos ndërmjet Serbisë dhe Kosovës, apo Malit të Zi dhe Serbisë, dhe mund të rrisë ndasitë me atë që mbeten jashtë nismën. /monitor.al/

## Ndërtimi i spitalit të Prishtinës do të nisë në vitin e ardhshëm

PRISHTINË, 29 GUSHT - Kryetari i komunës së Prishtinës, Përparim Rama, ka zhvilluar të hënën një takim me ministrin e Shëndetësisë, Rifat Latifi, me të cilin ka biseduar për ndërtimin e spitalit të Prishtinës.

Në "Facebook", Rama ka njoftuar se punimet për ndërtimin e spitalit do të fillojnë gjatë vitit 2023.

"Bashkë me drejtorin e Shëndetësisë, z. Izet Sadiku dhe me bashkëpunëtorë, u takuam me ministrin e Shëndetësisë, z. Rifat Latifi, me të cilin diskutuam për ndërtimin e spitalit të Prishtinës dhe bashkëpunimin në fushën e shëndetësisë sekondare. Punimet për Spitalin e Prishtinës janë duke ecur sipas

planit dhe presim që ndërtimi të fillojë gjatë vitit 2023. Bashkë me ministrin u dakorduam që të kemi një bashkëpunim të ngushtë për krijimin e një institucioni dhe sistemi të mirëfilltë shëndetësor, i cili do të ofrojë shërbime sa më cilësore për qytetarët e Prishtinës", ka njoftuar kryetari i Prishtinës, Përparim Rama.



## Policia nis patrullimet me vetura inteligjente


EPOKA  
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 29 GUSHT - Drejtoria Rajonale Gjilan, Njësi Rajonal i Komunikacionit Rrugor Gjilan, ka filluar zbatimin e projektit "Patrullimi inteligjent" përmes automjeteve policore me pajisje inteligjente me qëllim të ngritjes së kapaciteteve operative që synojnë rritjen e sigurisë në komunikacionin rrugor.

Këto automjete janë të pajisura me sensorë dhe radarë të cilët gjatë lëvizjes së veturës monitorojnë rrugën, identifikojnë kundërvajtësit duke bërë matjen e shpejtësisë së mjeteve në lëvizje në këndin 360 shkallë, ka mundësinë për detektimin e tejkalimit në vijë të plotë, përdorimin e telefonit dhe kundërvajtjeve të tjera në komunikacionin rrugor duke dërguar të dhëna në kohë reale në bazën e të dhënave të Policisë së Kosovës.


Në ekranin e vendosur brenda veturës, zyrtarët policorë mund t'i shohin veturat që janë në rrugë se me çfarë shpejtësie po lëvizin, do të kenë informacione edhe për targat e veturës së detektuar e



detaje të tjera që e bëjnë më të lehtë identifikimin e kundërvajtësve.

Po nëpërmjet këtyre pajisjeve bëhet leximi i targave dhe


identifikimi i mjeteve të paregjistruara, targave të vjedhura, identifikimi i personave në automjetet në lëvizje të cilët janë të kërkuara



nga organet drejtësisë. Qëllimi i Policisë së Kosovës nuk është gjobitja e ngasësve të veturave, por parandalimi që të kemi sa më pak aksidente të

trafikut. Policia e Kosovës është e përkushtuar për krijimin e një ambienti të sigurt për të gjithë qytetarët.

## Abetarja e parë e unifikuar Kosovë - Shqipëri më 1 shtator në duart e vogëlushëve



TIRANË, 29 GUSHT - Kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, në llogarinë e vet në "Facebook", ka paraqitur abetaren e parë të unifikuar Kosovë - Shqipëri. "Gëzuar abetaren e parë të unifikuar, krijesë e bashkimit të vullneteve të qeverive të Shqipërisë dhe Kosovës, për të gjithë fëmijët shqiptarë këtej e andej bjeshkëve, e kudo ata ndodhen", ka shkruar Rama

Ministrja e Arsimit në Shqipëri, Evis Kushi, ka theksuar se sot është dita e parë që mësuesit tanë në të gjithë vendin kthehen nga pushimet dhe fillojnë intensivisht punën për t'u përgatitur për fillimin e vitit të ri shkollor. "Nuk mund të nisnim më mbarë sesa me trajnimet e para të mësuesve për Abetaren e përbashkët unike, e cila tashmë është gati

dhe këtë shtator do të jetë në duart e çdo vogëlushi. Jam shumë e lumtur që në datën 1 shtator do të jem bashkë me ministrin Arbërie Nagavci në ditën e parë të shkollës në Kosovë, ku prej andej do të nisim promovimin e risisë më të bukur për të gjithë nxënësit dhe mësuesit. Suksese dhe punë të mbarë për të gjithë mësuesit e Shqipërisë dhe Kosovës!", ka shkruar Rama.

## AGK-ja angazhon avokat për përfaqësimin e gazetarëve

PRISHTINË, 29 GUSHT - Yll Zekaj është angazhuar avokat në Asociacionin e Gazetarëve të Kosovës me mbështetjen e dhënë të OSCE Mission in Kosovo. AGK-ja ka theksuar se është

tejet i rëndësishëm përfaqësimi dhe mbrojtja ligjore për gazetarët, kameramanët dhe fotoreporterët, dhe kjo do të mundësohet me angazhimin e Zekajt. "AGK-

ja ju inkurajon që t'i raportoni rastet kur pengoheni gjatë kryerjes së detyrës, ose jeni subjekt i sulmeve dhe kërcënimeve", është theksuar në njoftimin e AGK-së.



# LDK-ja: Qeveri, pranoje planin dhjetëpikësh dhe shpëtoji qytetarët nga katastrofa energjetike

**EPOKA E RE** Albulena S. MAVRAJ

**PRISHTINË, 29 GUSHT** - Kriza energjetike në vend po shkon duke u thelluar, ndërsa Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) i ka bërë kërkesë qeverisë ta pranojë planin dhjetëpikësh të cilin e vlerëson shpëtues për qytetarët. “Si pasojë e keqmenaxhimit të qeverisë po bien edhe blloqet e KEK-ut në mënyrë të vazhdueshme, me ç’rast po bie edhe mirëqenia e qytetarëve deri në limitet e mbijetesës. Ende pa u rregulluar Blloku A5, bie Blloku A3, duke bërë kështu që KEK-u të mos prodhojë as gjysmën e kapacitetit të tij, ku 530 MWh janë jashtë prodhimit. Në këtë kontekst, i bëjmë thirrje qeverisë të pranojë planin tonë dhjetëpikësh dhe t’i shpëtojë qytetarët, sepse me qasjen e saj të deritanishme po e shpie vendin drejt katastrofës energjetike. Mos të harrojmë se këto reduktime të energjisë elektrike po ndodhin në pikë

të verës, gjersa ditët më të ftohta po vijnë. Ndërkaq, bazuar në paaftësinë e dëshmuar të kësaj qeverie, pritet të zgjatet edhe orari i reduktimeve”, është thënë në komunikatën e LDK-së.

Sipas kësaj partie, ka kaluar më shumë se një vit nga kriza energjetike, ndërsa qeveria kishte kohë të mjaftueshme të përgatitej që dimri që po vjen të jetë më lehtë i përballueshëm për qytetarët, mirëpo ajo dështoi në ditët më të nxehta të vitit - ditët e verës, ku konsumi i energjisë është më i ulët. “LDK-ja i kërkon qeverisë që të marrë masa dhe ta pranojë planin dhjetëpikësh për përballjen me krizën energjetike. I. Pagesa e menjëhershme e subvencioneve të premtuara prej 90 milion euro për çmimin e energjisë elektrike; II. Riparimi i Bllokut A5 i Termocentralit Kosova A; III. Krijimi i mekanizmave për furnizim me burime alternative për ngrohje me çmime të përballueshme për



qytetarët; IV. Përgatitja e planit të efijencës dhe kursimit të energjisë; V. Negocimi i kontratave afatgjate për furnizim me energji; VI. Zbritja e TVSH-së nga 8% në 0% për faturat e

energjisë; VII. Krijimi i subvencioneve të reja për qytetarët dhe bizneset; VIII. Largimi i tarifave diskriminuese të ZRRe-së; IX. Themelimi i bursës së përbashkët për energji

Kosovë-Shqipëri; dhe X. Përgatitja e Strategjisë afatmesme për rritjen e kapaciteteve gjeneruese me gaz dhe energji alternative”, është theksuar në komunikatën e LDK-së.

## Sindikalistët thonë se ndërprerja e grevës varet nga qeveria

**PRISHTINË, 29 GUSHT** - Bashkimi i Sindikatave të Pavarura të Kosovës (BSPK) më 29 gusht e ka ftuar Qeverinë e Kosovës të reflektojë lidhur me realizimin e kërkesave të tyre në mënyrë që të ndërpritet greva e nisur më 25 gusht.

Në grevë janë mesimdhënësit, edukatorët në kopshtet publike, shërbyesit civilë në institucionet lokale dhe qendrore të Kosovës.

Kërkesa kryesore e sindikatave të këtyre punëtorëve, drejtuar Qeverisë së Kosovës, është ndarja e nga 100 eurove për punëtorët derisa të hyjë në fuqi Projektligji për pagat.

Nënkryetari i Këshillit Grevist, Ali Gashi, tha se greva do të vazhdojë deri në realizimin e kërkesave të sindikalistëve. “BSPK-ja është jashtëzakonisht e interesuar të negociojë me zyrtarët e



qeverisë, prandaj i bëjmë apel ekzekutiv që të reflektojë që të

gjendet një zgjidhje për të dyja palët”, tha Gashi për “Radion

Evropa e Lirë”. REL ka kërkuar përgjigje edhe

nga zyra për informim e kryeministrit të Kosovës, Albin Kurti, lidhur me atë se a pritet ndonjë takim dhe zgjidhje me Këshillin Grevist, por deri më tani nga qeveria nuk kanë kthyer përgjigje.

Gashi tha se nëse qeveria nuk reflekton, greva nuk do të ndërpritet dhe nxënësit nuk do ta fillojnë vitin e ri shkollor, që duhet të nisë më 1 shtator.

Ditë më parë Ministria e Punëve të Brendshme e Kosovës ka hartuar Projektligjin për Pagat. Ky legjislacion duhet të kalojë fillimisht procedurat e konsultimeve paraprake e publike dhe, pas miratimit në qeveri dhe Kuvend, të publikohet në Gazetën Zyrtare të Kosovës.

Në projektligj, një kopje të të cilit e ka siguruar REL, thuhet se ai hyn në fuqi tetë muaj pas

## Banka Botërore: Kosova po dëshmon menaxhim të mirë ndaj krizave vitet e fundit

**PRISHTINË, 29 GUSHT** - Ministri i Financave, Punës dhe Transfereve, Hekuran Murati, ka pritur të hënën në takim drejtorin ekzekutiv të Bankës Botërore për Kosovë, Hayrettin Demircan, në kuadër të vizitës së tij të parë zyrtare në Kosovë. Ministri Murati e ka falënderuar Demircan për bashkëpunimin e suksesshëm me Bankën Botërore gjatë këtyre viteve, duke vënë theks në mbështetjen e

kësaj banke ndaj reformave strukturore dhe ekonomike në vend.

Gjatë takimit, ministri Murati e ka njoftuar Demircan lidhur me indikatorët e fundit makrofiskalë si dhe me masat e ndërmarra nga qeveria për mbështetjen e familjeve që nga fillimi i pandemisë.

Nga ana e tij, Demircan u shpreh se Republika e Kosovës edhe më tej po dëshmon menaxhim të

mirë ndaj krizave vitet e fundit, ku edhe konfirmoi mbështetjen e mëtutjeshme të Bankës në fusha me interes të veçantë për Kosovën.

Të dyja palët u pajtuan se sektori privat luan rol të rëndësishëm në zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik të vendit, prandaj IFC si pjesë e Grupit të Bankës Botërore do t’i shikojë mundësitë e rritjes së mbështetjes edhe për sektorin privat.





# Pesë barnat që e ndryshuan botën (dhe çfarë shkoi keq)



Nga Philippa MARTYR

Është e vështirë të matet ndikimi i një barne të caktuar në historinë botërore. Por më poshtëpo klasifikojmë 5 barna, për të cilat mund të themi me siguri se kanë sjellë një ndryshim të madh në jetën tonë, shpeshherë në mënyra që nuk e prisnim. Ato na kanë dhënë disa përfitime shëndetësore të pabesueshme. Por nga ana tjetër janë shfaqur me një trashëgimi komplikimesh, të cilat ne duhet t'i analizojmë në mënyrë kritike.

## 1. Anestezia

Në fundin e viteve 1700, kimisti anglez Xhozef Pristli prodhoi një gaz të cilin ai e quajti "ajri i azotuar" (oksid azoti). Kimisti tjetër anglez Hamfri Devi, mendoi se ai mund të përdorej si qetësues dhimbjesh në kirurgji. Në fakt u bë një ilaç rekreativ. Vetëm në vitin 1834, mbërritëm një moment tjetër historik. Kimisti francez Zhan-Baptist Dyma emërtoi një gaz të ri: kloroformi. Mjeku scokez Xhejms Simpson e përdori atë në vitin 1847 për të ndihmuar gjatë lindjes së grave. Shumë shpejt anestezia u përdor më gjerësisht gjatë operacioneve kirurgjikale. Përpara saj, pacientët vdisnin shpesh nga shoku nga dhimbja.

Por çdo ilaç që mund t'i bëjë njerëzit të pavetëdijshëm, mund të shkaktojë edhe dëme. Anestetikët e sotëm janë ende të rrezikshëm, për shkak të rreziqeve të shtypjes së sistemit nervor.

## 2. Penicilina

Ajo që i ndodhi në vitin 1928 mjekut scokez Aleksandër Fleming, është një nga historitë klasike të zbulimit aksidental të një ilaçi. Fleming shkoi me pushime, duke lënë në laborator disa kultura të bakterit streptokok. Kur u kthye nga pushimet, vuri re se penicilium (një ndotës mykotik) e kishte ndaluar rritjen e streptokokut. Patologu australian Hauard Florej dhe ekipi i tij, e stabilizuan penicilinën dhe kryen eksperimentet e para tek njerëzit. Me financimin e qeverisë amerikane, penicilina u prodhua në masë dhe e ndryshoi rrjedhën e Luftës së Dytë Botërore. Ajo u përdor për të trajtuar mijëra njerëz në front. Penicilina dhe pasardhësit e saj, janë ilaçe shumë të suksesshme të vijës së parë për gjendjet shëndetësore që dikur vranë miliona njerëz. Megjithatë, përdorimi i gjerë i tyre ka çuar në shfaqjen e llojeve të reja të baktereve që janë rezistente ndaj ilaçeve.

## 3. Nitroglicerina

Nitroglicerina u shpik në vitin 1847 dhe e zëvendësoi barutin si eksplozivi më i fuqishëm në botë. Por ajo ishte gjithashtu ilaçi i parë modern për trajtimin e anginës, dhimbja e fortë e gjoksit e lidhur me sëmundjet e zemrës. Punëtorët e fabrikës që ishin të ekspozuar ndaj eksplozivit, nisën të përjetojnë dhimbje koke dhe skuqje në fytyrë. Kjo ndodhi për shkak se nitroglicerina është një vazodilatator, pra i zgjeron enët e gjakut. Mjeku londinez Uilliam Murrel eksperimentoi me nitroglicerinë mbi veten e tij, dhe e provoi atë te pacientët e tij me anginë. Ata patën një lehtësim gati të menjëhershëm të dhimbjeve nëgjoks. Nitroglicerina bëri të mundur që miliona njerëz me anginë të kenë një jetë relativisht normale. Ajo i hapi rrugën prodhimit të ilaçeve të reja, atyre për uljen e presionit të gjakut, beta-blokuesit dhe statinave. Këto ilaçe kanë zgjatur jetën e miliona njerëzve, dhe e kanë rritur jetëgjatësinë mesatare në vendet perëndimore. Por për shkak se jetët e njerëzve janë zgjatur, sot ka norma më të larta të vdekjeve nga kanceri dhe sëmundje të tjera jo të transmetueshme. Pra, rezultoi që nitroglicerina të ishte një ilaç që e

ndryshon botën në mënyra të papritura.

## 4. Pilula

Në vitin 1951, avokatja amerikane e kontrollit të lindjeve Margaret Sanger i kërkoi studiuesit Gregori Pinkus të zhvillonte një kontraceptiv hormonal efektiv, që u financua nga filantropja e njohur Kethrin Mekormik. Pinkus zbuloi se progesteroni ndihmon në ndalimin e ovulacionit, dhe e përdori atë për të krijuar një pilulë eksperimentale. Testet klinike u kryen mbi gratë më të varfra, sidomos në Porto Riko, për shkak të frikës nga efektet anësore. Ilaçi i ri u prodhua nga kompania GD Searle & Co me emrin Enovid në 1960, me miratimin e Administratës Amerikane të Ushqimit dhe Barnave (FDA). Ai u pranua pasi rreziku i shtatzënisë, shihej si më i madh se rreziku i efekteve anësore, si mpiksja e gjakut dhe goditjet në tru. U deshën 10 vite vjet për të provuar një lidhje midis përdorimit të kontraceptivëve oralë dhe efekteve anësore serioze. Pas një investigimi të qeverisë amerikane në vitin 1970, nivelet e hormoneve në pilulën kontraceptive ranë ndjeshëm. Pilula shkaktoi ndryshime të mëdha demografike globale. Familje nisën të jenë më të vogla në numrin e anëtarëve, teksa u rritën të ardhurat pasi gratë ri-hynë në fuqinë punëtore. Por

kjo ngre pikëpyetjen se si mjekët kanë eksperimentuar me trupat e grave.

## 5. Diazepam

Benzodiazepina e parë, një lloj depresant i sistemit nervor, u zhvillua për herë të parë në vitin 1955 dhe u tregtua nga kompania "Hoffmann-La Roche" me emrin Librium. Kjo dhe barnat e lidhura me to nuk u shitën si "kurë" për ankthin. Përkundrazi, ato ishin menduar t'indihmonin njerëzit të përfshiheshin në psikoterapi, e cila shihej si zgjidhja e vërtetë. Kimisti polako-amerikan Leo Sternbah dhe grupi i tij kërkimor, e ndryshuan kimikisht Librium në vitin 1959, duke prodhuar një ilaç shumë më të fuqishëm. Ky ishte diazepam, i shitur nga viti 1963 me emrin Valium. Duke qenë një ilaç i lirë dhe lehtësisht i disponueshëm, ai pati një ndikim të madh. Gjatë viteve 1969-1982, Valiumi ishte barna më e shitur në Shtetet e Bashkuara. Këto llojbarnash krijuan një kulturë të menaxhimit të stresit dhe ankthit përmes ilaçeve. Valiumi i hapi rrugën antidepressantëve modernë. SSRI i parë, ose frenuesi selektiv i rimarrjes së serotoninës, ishte fluoksetina, i shitur nga viti 1987 si Prozac. /

"The Conversation" – Bota.al

**EURO GLASS**  
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON Enverti  
Adr: Fushë Kosovë  
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336  
E-mail: euro.glass@live.com



**QENDRA SPORTIVE 'BUJQËSIA'**  
TEL: 045/82 82 82

## Kastrati paraqitet te Ferencvaroshi: Dua ftesë nga trajneri i Kosovës

BUDAPEST, 29 - Repreruesi i Kosovës në futboll, Lirim Kastrati, ka nënshkruar me skuadrën e njohur hungareze Ferencvarosh. Sulmuesi ka nënshkruar kontratë trevjeçare me klubin hungarez dhe do ta mbajë fanellën me numrin 10. Kastrati ishte lojtar i Legia Warszawas ku zhvilloi 16 paraqitje. "Disa klube me kanë kontaktuar në periudhën e kaluar, por Vidi u tregua opsioni më i mirë nga të gjitha pikëpamjet. Para se ta pranoja ofertën e klubit, fola me drejtorin sportiv Istvan Salloi dhe trajnerin Michael Boris dhe ishte shumë mirë që të dy donin që unë të transferohesha te Ferencvarosh", ka thënë Kastrati për faqen zyrtare të klubit. "Një nga gjërat më të rëndësishme për një lojtar është të ndiejë besim. Përveç dy profesionistëve, fola edhe me ish-bashkëlojtarin tim, Myrto Uzuni, për futbollin hungarez dhe Vidin. Edhe ai, gjithashtu, tha vetëm gjëra të mira si për kampionatin ashtu edhe për ekipin e Ferencvaroshit. Mendoj se kjo është një mundësi e mirë për mua që ta tregoj veten. Qëllimi im është të përformoj në atë



mënyrë që trajneri i Kosovës të llogaritet përsëri tek unë", ka

deklaruar Kastrati. Kastrati ka debutuar me fanellën e

"dardanëve" në vitin 2018, kurse është paraqitur 17 herë për

Kosovën dhe ka shënuar një gol në Ligën e Kombeve.

## Superliga e femrave në basketboll pritet të jetë shumë interesante



Prishtinë, 29 gusht - Superliga e femrave në basketboll pritet të jetë mjaft interesante. Në elitën e femrave ekziston një rivalitet i madh dhe kjo pritet të vazhdojë edhe në këtë edicion. Penza, Prishtina dhe Bashkimi kanë luftuar për trofe në vitet e fundit dhe ky rivalitet është rritur edhe më shumë me pjesëmarrjen e tyre në Ligën Unike, ku Prishtina e fitoi për herë të parë, ndërsa Superkupën Mbarëkombëtare e kishte fituar Penza. Skuadra pejana është kampione e Kosovës, ku mundi në finale Prishtinën, ndërsa vashat pejana kishin fituar edhe

Superkupën. Ndërkohë, Kupën e kishte fituar Bashkimi i Prizrenit. Kjo pritet ta bëjë edhe më interesante edicionin e ri, gjithashtu duke marrë parasysh transferimet e skuadrave që kanë bërë, për të dëshmuar se hyjnë fuqishëm në synimet që kanë. Në elitë garojnë edhe Vëllaznimi e Trepça, skuadra me traditë në basketbollin e Kosovës, ndërsa nga Liga e Parë është inkuadruar United Basketball nga Gjilani. Xhiroja e parë do të zhvillohet më 15/16 tetor, ku qysh në xhiron e parë do ta kemi derbin e parë në mes të Bashkimit dhe Penzës.

## Endrit Krasniqi, 'ylli i javës' në Superligë

PRISHTINË, 29 GUSHT - Federata e Futbollit e Kosovës së bashku me sponsorin e Superligës, Albi Mall, vazhdojnë ta japin çmimin "ylli i javës" pas çdo xhiroje në Albi Mall Superligë. Çmimi i më të mirit në javën e katërt i ka takuar futbollistit të FC Prishtina, Endrit Krasniqi. Komisioni vlerësoi se Endrit Krasniqi me lojën e shfaqur kundër Llapit ishte më meritori

për fitoren e FC Prishtina me rezultat 2-1 në "Zahir Pajaziti". Ai fillimisht nxori penallti në minutën e 13, të cilën në gol e shndërroi Kreshnik Uka, ndërsa në minutën e 58 shënoi golin që e vulosi fitoren e bardhekaltërve. "Besoj se ky çmim është meritë e gjithë skuadrës, natyrisht edhe e imja. Si unë personalisht, ashtu edhe i gjithë ekipi patëm paraqitje

shumë të mirë në ndeshjen me Llapin, por në të njëjtin nivel kemi luajtur edhe në ndeshjet e deritanishme. Mendoj se në Prishtinë është duke u bërë një organizim shumë i mirë dhe kjo na jep shpresë që të vazhdojmë të punojmë me përkushtim dhe t'i marrim ndeshjet një nga një", ka theksuar Krasniqi pas marrjes së këtij çmimi.



## Marku: Kam edhe dy duele të tjera këtë vit, mbështetja juaj është forca ime

TIRANË, 29 GUSHT - Boksieri shqiptar Florian Marku, që pak ditë më parë mori titullin e përkohshëm të kategorisë WBC Silver, ka folur në rrjetet sociale për emocionet e përjetuara mbrëmjen e 25

gushtit në "Air Albania", kur mundi rivalin meksikan. "Një për të gjithë e të gjithë për një. Përkrahja juaj është forca ime. Do të vazhdoj më fort se kurrë, më shumë punë dhe me kokën poshtë t'ju bëj krenarë të

gjithëve", ka shkruar Marku, i pamposhtur në karrierën e tij. Më tej, boksieri nga Lushnja zbulon planet për të ardhmen. "Do të pushoj disa ditë me familjen dhe do t'i rikthehem stërvitjes, si asnjëherë më parë,

për t'i korriguar gabimet që bëra në këtë sfidë. Do të kem edhe dy sfida të tjera brenda këtij viti, që më shumë mundësi do të jenë në Mbretërinë e Bashkuar", ka thënë Marku.



## Muriqi: Clubb Brugge bëri lojë, ju tregoj të vërtetën e dështimit të transferimit

MALLORCA, 29 GUSHT - Vedat Muriqi ka rrefyer në Supersport çfarë i ndodhi me Clubb Brugge, që kishte rënë dakord ta blinte nga Lazio për 10.5 milionë euro. "E vërteta është se ishte lojë e klubit belg për ta ulur çmimin, gjë kjo aspak profesioniste. Kam bërë disa transferime që merrnin kohë, ndërsa me Club Brugge u arrit gjithçka në 3-4 ditë dhe u habita, pasi isha edhe me pushime. Kisha një ndjenjë të keqe, pasi kur mbërrita në aeroport nuk kishte asnjë pjesëtar të klubit, por vetëm menaxherët. Po mendoja se nuk mund të ndodhte kështu, përderisa do të isha blerja rekord për klubin. Më vendosën në një vilë pasi, mesa duket, s'kishte asnjë hotel, por pranovë", ka thënë Muriqi. "Nuk mora asnjë mirëseardhje dhe ditën e vizitave ishte vetëm doktori i klubit që do t'i bënte testet. Ajo që thanë ata është një test me maskë dhe nëse nuk ke bërë stërvitje e ke të vështirë të kalosh kufirin. U thashë se jam pa stërvitje dhe nuk dua të kem të njëjtat probleme dëmtimi si te Lazio në fillim, ndaj e ndërpreva. Më pas më thanë se



s'munda t'i kaloja testet mjekësore. Mendova mos kisha probleme me zemrën, por jo më thanë, kisha të testet fizike. Pastaj kërkuan të më huazonin, pasi kështu mund të ulej çmimi i kartonit, por unë u ndjeva keq dhe fola me drejtuesit e Lazios. I jam

mirënjohës Igli Tares që më ka mbështetur që ditën e parë dhe pasi i tregova historinë, më mbështeti e më tha se do të flisnin drejtuesit e Lazios me ata të Club Brugge. Më pas u ktheva në stërvitje dhe ja ku jam sot", ka deklaruar Muriqi.

## Verstappeni thumbon Ferrarin: Në Belgjikë ishim të pakonkurrencë

BRUKSEL, 29 GUSHT - Më 93 pikë avantazh ndaj rivalëve, piloti holandez i Red Bullit, Max Verstappen, ka hipotekuar titullin kampion bote në Formula 1. Ai e nisi garën e Belgjikës nga vend i 14-t dhe pa shumë mund e fitoi atë, duke korrur suksesin e nëntë sezonal në 14 gara të zhvilluara deri më tani. Holandezi falënderoi për këtë triumf skuadrën e tij, që i ka dhënë mundësinë të ndërtojë një makinë të shpejtë, që ai e krahasoi me një raketë. "Fitore fantastike. Në Belgjikë kisha një makinë që dukej si një raketë, ishte shumë e shpejtë dhe nuk na ndalte dot askush", ka thënë Verstappen. "Tani na duhet



vetëm të mendojmë të bëjmë sa më shumë pikë për ta mbyllur këtë sezon në mënyrën më të mirë të mundshme. Nëse

vazhdojmë kështu, s'na kap dot njeri dhe do të duelojmë për fitore të dyfishtë në çdo pistë", u shpreh Max Verstappen.

## Aubameyang u përjeton tmerrin nga hajdutët

Pierre-Emerick Aubameyang dhe familja e tij kanë përjetuar një tmerr të vërtetë teksa në orën 1 të mëngjesit, kur futbollisti dhe të afërmit e tij ndodheshin në shtëpi, disa persona me kapuçë dhe armë

kanë kërcënuar dhe më pas dhunuar sulmuesin e Barcelonës. Personat, ende të paidentifikuar, janë futur nga kopshti i shtëpisë ku i kanë vendosur armën në kokë sulmuesit nga Gaboni, më pas

kanë ushtruar dhunë fizike dhe psikologjike mbi të dhe bashkëshorten e tij duke i kërkuar t'i tregonin se ku ndodhej kasaforta. Autorët, pasi kanë marrë atë që dëshironin, para dhe shumë

bizhuteri, janë larguar nga shtëpia e Aubameyangut me një Audi A3. Autoritetet lokale janë vënë në ndjekje të autorëve, por pa mundur ta bëjnë identifikimin apo ndalim e tyre. Aubameyang nuk është

një rast i izoluar në radhët e Barcelonës pasi më herët pre e hajdutëve kanë rënë edhe Jordi Alba, Pique e Semedo, ndërsa edhe Leawndowskit pak ditë më parë i vodhën orën pranë stadiumit "Camp Nou".

### SHKURT

#### Filloi edicioni evropian për gjyqtarët nga Kosova

Gjyqtarët e Kosovës në hendboll, Arsim Vitaku e Erdoan Vitaku, kanë nisur me ndeshje evropiane për edicionin 2022/2023. Në edicionin e ri gjyqtarët e hendbollit të Kosovës pritet të kenë angazhime të shpeshta në kupa evropiane, ndërsa çifti Vitaku tashmë ka drejtuar ndeshjen e parë. Në kuadër të raundit të parë kualifikues të Ligës Evropiane (meshkujt) janë takuar dy skuadrat norvegjeze, Kolstad Handball dhe Drammen HK. Ndeshjen e fortë dhe interesante e fitoi Kolstadi me rezultat 28:26. Pas pjesës së parë rezultati ishte 15:14. Të pranishëm në ndeshjen ishin mbi 2000 shikues.

#### Xavi: Lewandowski, lider i lindur

Barcelona dhuroi spektakël ndaj Valladolidit teksa katalanasit triumfuan 4-0. Lojtari i ndeshjes përsëri ishte Robert Lewandowski, i cili edhe në këtë ndeshje arriti të shënonte dopietë duke udhëhequr Barçën drejt fitores. Trajneri Xavi Hernandez nuk i ka kursyer lavdet për polakun, teksa ka theksuar se Lewandowski është një lider i lindur dhe se janë me fat që e kanë në "Camp Nou". "Që Lewandowski shënon, kjo nuk është risi për mua apo për të tjerët. Unë dua të ndaj diçka tjetër me ju, dua të ndaj mënyrën se si ai luan, se si e zgjedh kohën, se si lëviz, se si e mbron topin. Të gjitha i bën në mënyrë të shkëlqyer. Ai është një lojtar fantastik, spektakolar. Ai është një lider i lindur. Unë dhe Barcelona jemi të bekuar që e kemi në skuadër, sepse ai është një shembull për të gjithë, një punëtor i palodhur dhe shumë modest. Duket sikur e gjithë skuadra punon për të por, në fakt, ai po punon aq shumë për skuadrën, është një lojtar që di të bëjë diferencën në fushë, komunikon me të rinjtë dhe i udhëzon", ka thënë Xavi.

#### Ancelotti: Arritëm fitore të merituar ndaj Espanyolit

Trajneri i Real Madridit, Carlo Ancelotti, ka folur pas fitores ndaj Espanyolit (3-1). Pas ndeshjes trajneri italian ka thënë se skuadra e tij në fund është shpërblyer për angazhimin që kishte në këtë ndeshje. "Loja u ndërlikua, mund të ndodhë... pjesa e dytë ishte më e komplikuar dhe pak nga pak rritëm ritmin, vendosëm intensitetin dhe mundi në fund u shpërblye. Nuk ka qenë e lehtë të fitosh tri ndeshjet jashtë shtëpisë, por jemi në një dinamikë shumë të mirë", ka thënë Ancelotti.

#### Alonso: Hamiltoni është idiot

Çmimi i Madh i Belgjikës nuk nisi ashtu si duhet për dy pilotët, Fernando Alonso dhe Lewis Hamilton, që u përplasën në startin e garës. Komisionarët e Formulës 1 e cilësuan këtë aksident si një incident dhe nuk pati penalizime për Hamiltonin, me britanikun që pranoi fajin. Në përfundim të garës reagoi ashpër edhe ish-piloi i Ferrarit, spanjoli Fernando Alonso, që e cilësoi britanikun si idiot dhe tha se ai di të garojë vetëm kur niset i pari. "Çfarë idioti! Ky djalë nuk di se çfarë bën. Di të garojë vetëm kur niset i pari", u shpreh Alonso.



Republika e Kosovës  
Republika Kosovo-Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada-Government  
MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCËS, TEKNOLOGJISË DHE INOVACIONIT  
AGJENCIA PËR ARSIM DHE AFTËSIM PROFESIONAL DHE ARSIM PËR TË RRRITUR  
AGENCY FOR VOCATIONAL EDUCATION AND TRAINING AND ADULT EDUCATION

Nr: 609/1  
Dt: 29.08.2022

Në bazë të Ligjit për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës Nr. 04/L-032, Neni 8 i Ligjit të Punës nr. 03/L-212, Neni 13 dhe 34 të Ligjit për Arsimin dhe Aftësimin Profesional 04/L-138, Udhëzimit Administrativ Nr. 05/2012 (Neni 4), Udhëzimit Administrativ 05/2021, Udhëzimit Administrativ 05/2015, Udhëzimit Administrativ 07/2017 si dhe në bazë të kërkesave të shkollave, Agjencioni për Arsim dhe Aftësim Profesional dhe Arsim për të Rritur shpall:

### SHPLLJE E KONKURISIT

Për plotësimin e vendeve të lira në Qendrën e Kompetencës "Shtjefën Gjeçovi" në Prishtinë dhe Qendrën e Kompetencës "Kujtim Krasniqi" në Malishevë për vitin shkollor 2022/2023

Niveli	Institucioni/Shkolla	Vendi	Pozita/Vend i lirë	Vendi lirë/ Zëvendësim
SHML	Qendra e Kompetencës "Shtjefën Gjeçovi", në Prishtinë	Prishtina	Një (1) mësimdhënës/e për lëndën Matematikë, 11 orë mësimore;  Një (1) mësimdhënës/e për lëndët profesionale të Mekatronikës, 20 orë mësimore;	Vend i lirë  Vend i lirë
SHML	Qendra e Kompetencës "Kujtim Krasniqi" në Malishevë	Malishevë	Një (1) mësimdhënës/e për lëndën Gjuhë Gjermane (20 orë mësimore);	Vend i lirë

#### Detyrat dhe Përgjegjësitë për mësimdhënës të nivelit të IV-të;

- Mësimdhënësi është i obliguar ta realizojë planprogramin mësimor për vendin përkatës të punës duke u bazuar në Ligjin mbi Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës dhe në aktet e tjera nënligjore, të cilat i rregullojnë fushat përkatëse relevante për vendin e tij/ saj të punës.
- Të zbatojë detyrat e punës duke siguruar cilësinë dhe kompetencën profesionale në procesin e mësimdhënies.
- Të zbatojë metodologjitë e reja të mësimdhënies dhe të vlerësimit në përputhje me udhëzimet e planprogramit të ri.
- Të tregojë respekt dhe të silltet me drejtësi e pa dallime me njerëzit me të cilët punon.
- Të respektojë autoritetin e drejtpërdrejtë të zyrtarit të cilit i raporton dhe t'i kryejë detyrat që mund t'ua caktoj ai/ajo. Detyrat e punës duhet të jenë në harmoni me legjislacionin në fuqi.
- Nuk mund të kërkoj apo të pranoj udhëzime lidhur me kryerjen e detyrave të punës nga asnjë organ tjetër përveç Organit Drejtues të Qendrës Kompetencës dhe AAAPARr-së.
- Nuk lejohet shfrytëzimi i pozitës për përfitime private në dobi të ndonjë pale të tretë.
- Diagnostifikon kushtet për mësim dhe proceseve mësimore të nxënësve përmes proceseve të përshtatshme dhe reagon në mënyrën e duhur ndaj tyre, duke filluar masa të ndryshme mbështetëse individuale ndaj nxënësve.
- Puna monitorohet dhe vlerësohet mbi bazën e rezultateve të arritura të nxënësve sipas procedurave profesionale nga ana e ekspertëve përkatës.

#### Kualifikimi dhe shkathtësitë e kërkuara për mësimdhënës:

- Diploma e përgatitjes profesionale e nivelit të 7 sipas KKK;
- Letërmjofitimi (fotokopje);
- Certifikata për trajnimet e kryera;
- Vërtetimin e përvijës punës në arsim;
- Për të gjitha vendet e shpallura në konkurs kërkohet përgatitja adekuate profesionale;
- Ai ose ajo duhet të jenë në gjendje të punojnë nën tryzni, të ketë etikë të lartë të punës dhe shkallë të lartë integriteti;
- Procedurat e konkurrimit:**
- Afati i konkurrimit është 7 ditë nga dita e shpalljes. Aplikacionet dhe dokumentet e kërkuara duhet të merren dhe dorëzohen në administratën e institucioneve në të cilat është shpallur konkursi gjegjësisht në Qendrën e Kompetencës "Shtjefën Gjeçovi" në Prishtinë dhe Qendrën e Kompetencës "Kujtim Krasniqi" në Malishevë.
- Aplikacionit duhet t'i bashkëngjiten kopjet e dokumentacionit mbi kualifikimin (për të diplomuarit jashtë vendit dëshmitë e nostrifikimit të diplomës), dëshmia për përvijën e punës, dëshmia që nuk janë nën hetime dhe dokumentacionet tjera të nevojshme që kërkohen për vendin e punës.
- Kërkesat e arritura pas mbylljes së konkursit, dhe aplikacionet e pa kompletuara nuk shqyrtohen. Kandidatët të cilët do të ftohen në intervistë duhet t'i sjellin në shikim dokumentet origjinale.



## Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punës
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgatitjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook

[www.facebook.com/gjejpuneshpejte](http://www.facebook.com/gjejpuneshpejte)

## RESTAURANT

# SWISS

## TAVERNA

Tel: +377 45 400 156

+386 49 848 553

PRISHTINË

### >> SHPLLJE TË VOGLA <<

- Gentjan Basha, Peran Shqipëri, shpall të pavlefshme dëftesën e klasës së -X-, të SH.M.T. "Nexhmedin Nixha", Drejtimi: Automekanik, Gjakovë.
- Leonora Kulludra nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e SH.M. Ekonomike "Kadri Kusari".
- Sevdije Berisha, fshati Drenoc, komuna e Rahovecit, shpall të pavlefshme dëftesën nga klasa e -I- deri -VIII- të SH.F. "Vëllezërit Frashëri".
- Ardian Nikollbibaj nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e SH.M. Teknike "Nexhmedin Nixha" Gjakovë, drejtimi teknik i Elektroteknikes.
- Fatinda Muca shpall të pavlefshme dëftesat e kl VI - IX shfmu "Abdyl Frashri " Prizren.
- Taulant Ermeni nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e kl. X, XI, XII, XIII dhe diplomën e SH.M. Ekonomike " Kadri Kusari"
- Ujkan Lila nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesën e SH.M.U "Yli Morina" nga kl. I-V dhe VI-IX.
- Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.
- Shemsije Emraj shpall të pavlefshme certifikatën shmlt " 11 Marsi " Prizren.
- Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.
- Kastriot Ninaj shpall të pavlefshme diplomën shmlt "11 Marsi " Prizren.
- Urgjentisht kërkoj një banesë me qira ne Prishtine. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188
- Asad Jusufi shpall të pavlefshme dëftesat e kl I - VIII shfmu " Nefit Jusufi " Skorobisht.
- Merita Mulaj shpall të pavlefshme diplomën e shkollës së mesme të mjekësisë "Ali Sokoli" Prishtinë.
- Alban Gunga nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesën e plotë SH.F.M.U. "Mustafa Bakija" Gjakovë nga kl. I-V dhe VI-IX.



## ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

### Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comercio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

